Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " Nr. 12/2019) dhe në përputhje me nenin 40 fq 2 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 4, nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve të dorëzuara, duke vepruar sipas denoncimit të pranuar nga parashtrues i njohur në vazhdimin e dytë të seancës së 50-të, të mbajtur më 23.07.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i dorëzuar me datë 23.02.2021 nga //// në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të cilit është formuar lënda me numër 12-2211/1 të datës 15.06.2020, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 12/19), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se është kompetent organ tjetër të vepron në denoncimin e theksuar më sipër.

Lënda me numër arkivor 12-2211 e vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetërorë për parandalim të korrupsionit, me arsyetim.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim- në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të saj në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2211/1 e datës 15.06.2020 u formua në bazë të denoncimit të marrë nga ///nga /// (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi).

Në denoncim citohet se deri te parashtruesi ishte dorëzuar kallëzim penal, e regjistruar nën numrin e arkivit të tij ///-/// nga /// , i cila kallëzim penal ishte dërguar nga grup

qytetarësh nga / // kundër një investitori të panjohur, për një akt ndërtimi pa leje të një ndërtese në rr. "///" (///) në Komunën e ///. Në kallëzimin penal ishte cituar se do të dorëzohen edhe denoncime tjera në Prokurorin Themelore Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe Drejtorisë së Policisë Financiare. Kështu, kallëzimet penale të dorëzuara, parashtruesi me parashtresë të regjistruar nën numrin e tij të arkivit // /-/// nga /// , ia dorëzoi inspektorit kompetent të ndërtimit të Komunës ///, ku u kërkua që brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të veprohet sipas të njëjtit. Kjo në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Planifikimin Hapësinor dhe Urban dhe Ligjit për Ndërtim, siç është deklaruar nga parashtruesi, ishte në kompetencën e komunës brenda së cilës është kryer ndërtimi, dhe në këtë rast të veçantë ishte Komuna ///, për arsye se bëhej fjalë për miratimin dhe ekzekutimin e akteve administrative për objektet e kategorisë së dytë. Duke vepruar kështu, paraqitësi deklaron se ai duhet të ishte informuar për veprimet ligjore të ndërmarra, por nuk mori asnjë përgjigje, për shkak të së cilës parashtruesi u detyrua të paraqesë një Urgjencë të regjistruar nën numrin e tij të arkivit ///-// / nga // / , dhe pas së cilës urgjencë përsëri nuk u mor asnjë përgjigje se ishte vepruar. Prandaj, parashtruesi dyshon se Komuna e /// nuk kishte asnjë dokument për të justifikuar ndërtimin e objektit, si dhe e njëjta ishte ndërtim ilegal. Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë: KSHPK) propozon që menjëherë t'i drejtohet Komunës /// dhe të kërkojë një shpjegim të detajuar të objektit konkret, si dhe të fillojë procedurat kundër të gjithë atyre që ishin pjesë e këtij, siç citon parashtruesi, "krimi, të përgjigjen menjëherë para Ligjit". Dëshmi ndaj denoncim nuk janë bashkangjitur.

Pas shqyrtimit të pohimeve në denoncim, KSHPK përfundon se nuk ka elemente për veprimin e tij kompetent në këtë rast në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12 /19). Kjo për faktin se KSHPK vlerësoi se organ tjetër është kompetent të veprojë sipas denoncimit së marrë, lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Në të vërtet, në përputhje me dispozitat e Ligjit të lartpërmendur, KSHPK nuk ka kompetencë të vlerësojë veprimet e inspektorëve kompetentë të ndërtimit në përputhje me rregulloret dhe standardet e ndërtimit, as të marrë masa për kryerjen e veprimeve administrative nga njësit e vetëqeverisjes lokale. Kjo është aq më tepër që sipas dispozitave të Ligjit për Inspektimin

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 50/10 ... 120/18), funksionimi i shërbimeve inspektuese në përputhje me ligjet, rregulloret dhe standardet është në ngarkim të Këshillit të Inspektimit, sipas të cilit në përputhje me nenin. 19-a të të njëjtit ligj, drejtori i parashtruesit është i detyruar të kërkojë nga Këshilli i Inspektimit që të fillojë procedurë disiplinore kundër inspektorit kompetent të ndërtimit të Komunës ///, në afat brenda gjashtë muajve nga dita e njohjes së shkeljes së kryer, por jo më gjatë se tre vjet nga dita e kryerjes së shkeljes, nëse për këtë ekziston bazë ligjore , e mbështetur me prova nga të cilat mund të përcaktohet situata e saktë faktike në këtë rast të veçantë.

Lidhur me pohimet se parashtruesi nuk ka marrë përgjigje për veprimin e inspektorit kompetent të ndërtimit të Komunës ///, në përputhje me nenin. 138 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 124/15) një kompetencë e tillë i përket Inspektoratit Administrativ Shtetëror, i cili ndërmerr aktivitete inspektuese që lidhen me funksionimin administrativo-ligjor të organeve publike në Republika së Maqedonisë së Veriut, pas parashtresës së dorëzuar dhe / ose sipas detyrës zyrtare. Kjo është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Inspektimin Administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 69/04 ... 11/18).

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
- Parashtruesi
- Arkivi i KSHPK -së

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së